

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

E la të gjakosur para spitalit dhe tentoi të arratisej drejt Shqipërisë, zbulohet e shkuara e 'Majmunit', shqiptarit që akuzohet për vrasjen e 46-vjeçares në Itali

2

sportiv mes Vlorës dhe Radhimës: Vendi perfekt për të mbyllur verën (FOTOT)

3

'E dua këtë vend', Richard Grenell me pushime në bregdetin shqiptar! Shfaqet një boshllëk të madh në bankat e shkolles dhe në zemrat e shokëve

4

Humbi jetën në aksidentin tragjik në Manë, misuesit e 15-vjeçarit: I kja e tij të një lokal! Shqiptaro-britaniku e qelloi me grushte, alibia e autorit: Thikën e kishte portugez, ia mora nga dora dhe e godita (VIDEO)

5

Dinamika/ Dy punonjësit e 'Principotes' e vranë turistin për zhurmën në lokal! Shqiptaro-britaniku e qelloi me grushte, alibia e autorit: Thikën e kishte portugez, ia mora nga dora dhe e godita (VIDEO)

6

Dhunuan shefin e Krimeve në Sarandë, i thanë në burg administratori i 'Orange Club' dhe 5 personat e tjerë

Kronikë

Grabitja në argjendarinë në Paskuqan, arrestohet njëri prej autorëve! Po tentonte të kalonte kufirin në Qafë Thanë, policia: Gjendet edhe kallashnikovi (EMRI+VIDEO)

Në pranga ka rënë Argys Kalsi. Policia prej disa ditësh e kishte identifikuar të riun si autor i ngjarjes, por nuk e kishte arrestuar pasi e kishin ndjekur dhe përgjuar në mënyrë që të arrestojnë dhe autorin e dytë, për të cilin po punohet për identifikimin e tij.

■ Policia zbulon detaje nga hetimet, autorët përdorën maska silikoni për të fshehur identitetin

REPORT TV

Grabitja në argjendarinë në Paskuqan, arrestohet njëri prej autorëve!

Report TV

Watch on

[Sh].com

Redaksia

18 Gusht, 09:28 | Përditësimi: 19 Gusht, 15:15

Share

Post

WhatsApp

Policia e Tiranës dhe Komisariati nr. 5 kanë arrestuar njërin prej autorëve të dyshuar të **grabitjes me armë zjarri** në argjendarinë 'Luani' në Paskuqan. Në pranga ka rënë **Argys Kalsi**.

Burime bëjnë me dije se 35-vjeçari është arrestuar në **Qafë Thanë** teksa po mundohej të largohej nga vendi. Në momentin që ai ka tentuar të kalojë kufirin, Kalsi është arrestuar menjëherë nga blutë.

Në fakt, policia prej disa ditësh e kishte identifikuar të riun si autor i ngjarjes, por nuk e kishte arrestuar pasi e kishin ndjekur dhe përgjuar në mënyrë që të arrestojnë dhe autorin e dytë, për të cilin po punohet për identifikimin e tij.

LEXO EDHE: Zjarr pranë QSUT-së në Tiranë, digjet banesa private! Flakët vihen nën kontroll, gjyshja dhe mbesa shpëtojnë pa lëndime (VIDEO)

Policia bën me dije se më 6 gusht, në një pyll pranë fshatit Zgafnur, ka gjetur kallashnikovin e përdorur, krehër me fishekë, një skafandër motoçiklete të lyer në ngjyrë gri, 2 maska silikoni dhe një palë doreza. Tri ditë më vonë, gjeti të hedhur në një liqen në fshatin Qinam edhe **motorin e përdorur** nga dy autorët, me të cilin ata u arratisën duke përdorur **rugët periferike të Kamzës** dhe shmangur ato kryesore.

Në grabitjen e ndodhur më 5 gusht, autorët hynë të maskuar e me kallashnikov, kanosën punonjësen dhe grabitën sende floriri me një vlerë rreth 1.5 milionë lekë. Dyshohet se njëri prej tyre të ketë shkuar si klient ditë më parë, pasi kishin dijeni të plotë ku ndodheshin bizhuteritë.

Lajm në përditësim...

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Rendit zhvillimet sipas orarit:

Ora 09:52

Grabitja në argjendarinë në Paskuqan/ Policia zbulon detaje nga hetimet, autorët përdorën maska silikoni për të fshehur identitetin

REPORT TV

Grabitja në argjendarinë në Paskuqan, arrestohet njëri prej autorëve!

Report TV

Watch on

35-vjeçari Argys Kalsi është vënë në pranga si një prej autorëve për grabitjen e ndodhur më 5 gusht në argjendarinë 'Luani' në **Paskuqan**. Policia bën me dije se gjatë periudhës së hetimit, në një pyll pranë fshatit Zgafnur, ka gjetur kallashnikovin e përdorur, krehër me fishekë, një skafandër motoçiklete të lyer në ngjyrë gri, 2 maska silikoni dhe një palë doreza.

Maskat e silikonit duken tejet reale dhe imitojnë fytyrën e njeriut.

Më herët, Report Tv ka raportuar se ishte gjetur motori i përdorur nga autorët për t'u arratisur, i hedhur në një liqen në fshatin Qinam.

Njoftimi i policisë:

Kamëz/Vijojnë veprimet intensive hetimore për identifikimin dhe kapjen e autorëve të vjedhjes së një sasi bizhuterish në një argjendari në Kamëz, më datë 05.08.2026.

Identifikohet, kapet dhe vihet në pranga njëri prej autorëve të dyshuar.

Sekuestrohen gjatë periudhës së hetimit arma e zjarrit automatik, motomjeti, veshjet, maska silikoni dhe një krehër me fishek.

35-vjeçari Argys Kalsi, një prej

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 5, si rezultat i punës intensive hetimore dhe procedurale, të kryer për disa javë, me metoda proaktive, në drejtimin e Prokurorisë së Tiranës, kanë finalizuar operacionin e koduar "Gold", duke bërë të mundur identifikimin, kapjen dhe arrestimin e shtetasit:

-A. K., 35 vjeç, banues në Laç.

Nga hetimet dyshohet se ky shtetas, në bashkëpunim me një shtetas tjetër ende të paidentifikuar, më datë 05.08.2026, kanë vjedhur një sasi bizhuterish në një argjendari dhe më pas janë larguar me një motomjet.

Në vijim të veprimeve të pandërprera hetimore dhe kërkimeve intensive në terren, më datë 06.08.2026, në një zonë të pyllëzuar të fshatit Zgafnur, u gjetën dhe u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri automatike, një krehër me fishekë, një skafandër motoçiklete e lyer me ngjyrë gri, dy maska silikoni, një palë doreza, si dhe veshje të tjera që dyshohet se janë përdorur nga autorët gjatë kryerjes së veprës penale.

Gjithashtu, më datë 09.08.2026, në vendin e quajtur "Liqeni i Qinamit", fshati Qinam, u gjet dhe u sekuestrua, në cilësinë e provës materiale, një motomjet i cili dyshohet se është përdorur nga autorët gjatë kryerjes së veprës penale.

Vijon puna për identifikimin dhe kapjen e bashkëpunëtorit tjetër, si dhe për dokumentimin e plotë të rastit.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprat penale "Vjedhja me dhunë e kryer në bashkëpunim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyeshe dhe i municionit".

P.J/Shqiptarja.com

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: argjendari luani qafe thane Argys Kalsi paskuqan grabitje Tirane

Sa e vlerësoni këtë artikull? 5.0 / 5 (3 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Ndalohejt repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës: Cili është shkaku i konflikteve në Shqipëri?

Politika Shoqëria Social media

15 Gusht, 13:45

Lajme të tjera

TIRANE

Nis hetimi për 28 të mitur në Kombinat, dyshohet se do konfliktoheshin me thika e kaçavida me njëri-tjetrin

19 Gusht, 13:19

TIRANE

Nga 'G Class' te 'AMG', sekuestrohen në Tiranë makina luksi me vlerë 450 mijë euro! Në kërkim 2 të rinjtë, 3 nën hetim (VIDEO)

19 Gusht, 12:30

TIRANE

I kërkuar në Kosovë për drogë, arrestohet në Rinas 32-vjeçari (EMRI + VIDEO)

19 Gusht, 09:53

TIRANE

Vetëm 5 vatra zjarri aktive në vend, 2 helikopterë punojnë për shuarjen e flakëve në Tërbus! Vijon ndërhyrja Në Dajt, Priskë e Lufaj

19 Gusht, 09:36

TIRANE

Kostot e larta 'zhvendosin' dhe lindjet nga Tirana, rënie me 5.5% në 6-mujorin e parë! Rritje në qarqe

19 Gusht, 09:22

TIRANE

Një udhëtim në Shqipërinë e 50 viteve më parë, Arkivi i Filmit nxjerr në dritë filmime të rralla, shpëtohen nga myku dhe harresa! (VIDEO)

18 Gusht, 19:39

TIRANE

Aksident tragjik në Tiranë, i ri në timon përplas për vdekje një grua në zonën e Misto Mames

18 Gusht, 19:11

TIRANE

Ambasada e Kazakistanit prezanton në Tiranë reformat kushtetuese, zgjedhjet për parlamentin e ri dhe planin për një linjë ajrore direkte me Shqipërinë

18 Gusht, 17:09

TIRANE

Firmoset udhëzimi për artin publik, asnjë monument apo instalacion nuk do të vendoset pa vlerësim profesional, Gonxhja: Fund ndërhyrjeve amatore pa sens artistik!

18 Gusht, 16:26

TIRANE

Beteja me flakët, 4 vatra aktive zjarri në Shqipëri! Gjatë ditës operacione me 2 avionë, 3 helikopterë dhe 140 efektivë të Forcave të Armatosura

18 Gusht, 10:17

KAMËZ

Grabitja në argjendarinë në Paskuqan/ Policia zbulon detaje nga hetimet, autorët përdorën maska silikoni për të fshehur identitetin

18 Gusht, 09:52

KAMËZ

Bjorn Runa: 'Fashistët' që protesta i zbuloi vetëm pasi u kthyen kundër saj

17 Gusht, 22:20

TIRANE

E la të gjakosur para spitalit dhe tentoi të arratisej drejt Shqipërisë, zbulohet e shkuara e 'Majmunit', shqiptarit që akuzohet për vrasjen e 46-vjeçares në Itali

19 Gusht, 23:15

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju Përditësimi

[Shqiptarja.com]

Facebook, Twitter, YouTube, Instagram, Telegram, Messenger, Email, RSS

Flags of Albania, Kosovo, and North Macedonia

Kërko

REPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

×

[Sh]

.com

Lajmi i fundit



E la të gjakosur para spitalit dhe tentoi të arratisëj drejt Shqipërisë, zbulohet e shkuara e 'Majmunit', shqiptarit që akuzohet për vrasjen e 46-vjeçares në Itali

19 Gusht, 23:15

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



GetButton